



Pranimi / Dorezuar Priljeva / Pristalo Received / Delivery	27.05.2022	2	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Priljeq Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SHKMSHCK	3139/2022		115



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.377/2022

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-** Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Jeton Koca-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.377/2022 të datës 14.04.2022 të parashtruar nga ankuesi dhe e regjistruar në emër të ankuesit

me adresë banimi Prishtinë, kundër Vendimit KD.nr.011.012.013 të datës 23.03.2022 të Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës, në çështjen juridike "masë disiplinore", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafi 1 nënparagrafin 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 27.05.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa A.nr.377/2022 e datës 14.04.2022 e parashtruar nga ankuesit dhe
- II. Anulohet Vendimi KD.nr.011.012.013 i datës 23.03.2022 i Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës dhe lënda kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje tek organi i njëjtë i cili e ka nxjerr aktin administrativ.
- III. Obligohet Komisioni Disiplinor në Shërbimin Korrektues të Kosovës, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të ndërmarr të gjitha veprimet ligjore për zbatimin e këtij vendimit ashtu siç është përcaktuar në pikën II të dispozitivit.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesit dhe të punësuar në Shërbimin Korrektues të Kosovës më datë 14.04.2022 kanë parashtruar ankesë me numër protokollit 2111/2022 në Këshillin

e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit KD.nr.011.012.013 të datës 23.03.2022 të Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës me pretendim ankimor se janë bërë shkelje thelbësore të dispozitave procedurale dhe shkelje thelbësore të së drejtës materiale.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (tutje Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 21.04.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesve tek Shërbimi Korrektues i Kosovës (me tej referuar SHKK), ndërsa Këshilli me datë 04.05.2022 ka pranuar shkresat lidhur me çështjen në procedurë.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova:** Ankesën me Nr.prot:2111/2022 të datës 14.04.2022 e parashtruar nga ankuesit në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër KD.nr.011.012.013 të datës nga Komisioni Disiplinor i Shërbimit Korrektues të Kosovës; Vendimin me numër 0139 të datës 11.02.2022 nga Zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës; Vendimin me numër 1187 të datës 20.10.2021 nga Zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës; Formën e përmbajtjes së dokumenteve në dosje nga oficeri të datës 21.01.2011; Vendimin e datës 20.01.2016 nga Drejtori i BSL-së; Thirrjen për intervistë të datës 12.01.2016; Inicimin e procedurës disiplinore për të datës 23.12.2015; Propozimin për masën disiplinore të datës 19.01.2016 për Vendimin e datës 12.01.2016 nga Drejtori i BSL-së; Intervistën e datës 13.01.2016 për Deklaratën e datës 12.12.2015 nga Deklaratën e datës 18.12.2015 nga Raportin e datës 12.12.2015 nga dhe Shkresën mbi orarin e oficerëve për ndërrimin e natës për datat 17-18.12.2015; Vendimin me numër 0202 të datës 18.02.2022 nga Zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës; Shkresën zyrtare të datës 22.12.2021 lidhur me inspektimin për beneficionet e të burgosurit F.M në BSL; Vërtetimin e datës 22.03.2022; Vërtetimin e datës 11.03.2022; Shkresën zyrtare me numër 0124 te datës 08.02.2022 lidhur me inicimin e procedurës disiplinore për ankuesin Vendimin me numër KD.nr.011.012.013 të datës 09.03.2022, nga Komisioni Disiplinor lidhur me shtyrjen e afatit për vendosje; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 21.04.2022 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 04.05.2022 nga Shërbimi Korrektues i Kosovës me shkresat e bashkangjitura të lëndës; Akt emërimit e nëpunësit të datës 05.03.2013; Kontratën e punës për kohë të pacaktuar të datës për nëpunësin Akt emërimit e nëpunëses të datës 21.10.2014; Kontratën e punës së ankuesit të datës 16.02.2018; Kontratën e punës së ankuesit të datës 03.01.2019; Vendimin me numër 4182 të datës 14.11.2019 nga Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues të Kosovës; Akt emërimit e ankuesit të datës 06.12.2017 së bashku me përshkrimin e detyrave të punës; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Zëvendës Drejtor në QP-Lipjan; Inicimin e procedurës disiplinore me numër 0124 të datës 08.02.2022 për ankuesin Procesverbalin e datës 16.03.2022, 08.03.2022 lidhur me intervistën e ankuesve; Raportin përfundimtar të hetimeve të datës 07.02.2022 nga Shërbimi Korrektues i Kosovës; Raportin final të datës 07.02.2022 lidhur me zbardhjen e rastit të realizimit të vizitës së lirë nga i burgosuri F.M në BSL; Vendimin me numër 0089 të datës 31.01.2022 nga Zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës; Kërkesën me numër 326 të datës 19.05.2021; Aktgjykimin me numër PS 54/20 të datës 18.02.2020 nga Gjykata Themelore ne Prishtine-Departamenti Special; Aktgjykimin me numër APS.nr.1/21 të datës 10.02.2021 të Gjykatës së Apelit të Kosovës; Shkresën

zyrtare të datës 11.11.2021 lidhur me llogaritjen e dënimit; Vendimin me numër 747 të datës 08.10.2019 lidhur me formimin e komisionit profesional; Formularin e vlerësimit për beneficione të datës 16.03.2021; Raportet e datës 16.03.2021 për pushimet jashtë burgut; Kërkesën e datës 15.03.2021 lidhur me realizimin e vizitës; Formën e panelit për beneficione të datës 16.03.2021; Formularin e vlerësimit për beneficione të datës 19.03.2021; Raportet e datës 19.03.2021, 22.03.2021 për pushimet jashtë burgut; Certifikatën e martesës së datës 16.03.2021; Formën e panelit për beneficione të datës 22.03.2021; Rivlerësimin për beneficione të datës 30.04.2021; Kërkesën e datës 29.04.2021; Formën e panelit për beneficione të datës 11.05.2021; Rivlerësimin për beneficione të datës 28.06.2021; Kërkesën e datës 21.06.2021; Formën e panelit për beneficione të datës 29.06.2021; Rivlerësimin për beneficione të datës 28.09.2021; Kërkesën e datës 28.09.2021; Formën e panelit për beneficione të datës 28.09.2021; Vendimin e datës 27.10.2020; Njoftimin e datës 23.03.2021, 25.05.2021, 21.07.2021, 28.09.2021; Shkresat zyrtare të datës 24.03.2021, 29.09.2021, 26.05.2021 dhe 21.07.2021; Udhëzimin administrativ me numër MD-NR.07/2015 për Rendin Shtëpiak në Institucionet Korrektuese.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët, konstatoi se janë përmbushur kushtet ligjore që lënda të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje të organi i njëjtë, *sepse*:

Nga administrimi i provave materiale lidhur me çështjen ankimore rezultoi se ankuesi sipas Kontratës së punës për kohë të caktuar të datës 16.02.2018 është i punësuar në pozitën Drejtori i Burgut të Sigurisë së Lartë. Ankuesi në bazë të Kontratës së punës për kohë të caktuar të datës 03.01.2019 është i punësuar në pozitën Zëvendës Drejtor i Burgut të Sigurisë së Lartë, ndërsa ankuesi sipas Kontratës së Punës Nr.097/QPP të datës 08.08.2008, është emëruar në pozitën e punës Udhëheqës për Administratë dhe Trajtim Psikiatrik të të Burgosurve në Klinikës Psikiatrike në Qendrën e Paraburgimit në Prishtinë, kurse me Vendimin me numër protokoll 295 të datës 28.02.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të SHKK-së ishte emëruar dhe ka ushtruar detyrën e U.d të Drejtorit të Burgut për Siguri të Lartë, e të cilën pozitë e ka ushtruar deri me datë 14.09.2021.

Bazuar në Raportin e Komisionit Hetimor me numër protokoll 0115 të datës 07.02.2022, Zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës me datë 08.02.2022 përmes shkresës më numër protokoll 0123, shkresës më numër protokoll 0124, dhe shkresës më numër protokoll 01245 ka iniciuar procedurën disiplinore ndaj ankueseve me pretendimet se të njëjtit me rastin e lejimit të realizimit të befinicionit për të burgosurin F.M kanë bërë shkelje të rënda të detyrës së punës të parapara me nenin 48 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ MD nr.07/2015 për Rendin Shtëpiak në Institucionet Korrektues si dhe nenin 46 paragrafi 3 pika 3.3 dhe 3.10 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Komisioni Disiplinor i SHKK-së me Vendimin KD.nr.011.012.013 të datës 23.03.2022, ndaj ankuesve veç e veç ka shqiptuar masën disiplinore "ndalimi 20% i pagës për periudhën prej një muaj" nga neni 47 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Ankuesit brenda afatit ligjor parashtrojnë ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit KD.nr.011.012.013 të datës 23.03.2022 të Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës, me pretendimet ankimore për shkelje thelbësore të dispozitave

procedurale dhe shkeljeve thelbësore të së drejtës materiale. Me tej shtojnë së Zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm me rastin e inicimit të procedurës disiplinore ndaj tyre ka ndryshuar tërë anëtarët e Komisionit Disiplinor të themeluar me Vendimin 118 të datës 20.10.2022, përbërja e Komisionit Disiplinor të themeluar nuk është në pajtim me nenin 10 të Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinon dhe Ankesat e Zyrtareve Publikë, anëtari i komisionit disiplinor z. Sadat Murturi nuk ka lajmëruar konfliktin e interesit në këtë procedurë, dhe se shkelje ka ndodhur si rezultat i mungesës së zyrtarit ligjor zëvendësimi i të cilit është përgjegjësi e vet Drejtorit të Përgjithshëm të SHKK-së.

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore, Kolegji nga analizimi i prova materiale ka konstatuar së Zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm të SHKK-së me Vendimin më numër protokoll 1187 të datës 20.10.2021 ka themeluar Komisionin Disiplinor me mandat tre vjeçar, ndërsa i njëjti dy ditë pas inicimit të procedurës disiplinore ndaj ankuesve konkretisht me datë 11.02.2022 ka ndryshuar në tërësi përbërjen e anëtarëve të këtij komisioni dhe ka themeluar Komision të ri Disiplinor sipas Vendimit me numër protokoll 0139 të datës 11.02.2022 pa dhënë ndonjë arsytim se për cilat shkaqe bëhet shfuqizimi i vendimit, kështu që një veprim i tillë sipas vlerësimit të Kolegjit krijon pasiguri juridike për nëpunësit civil në kuadër të Shërbimit Korrektues dhe si i tillë është në kundërshtim me parimin e ligjshmërisë të përcaktuar me nenin 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative me të cilin parashihet se: *1. Organet publike veprojnë në përputhje me Kushtetutën, legjislacionin në fuqi, si edhe me rregullat e përgjithshme administrative të zbatueshme brenda kompetencave të tyre dhe në përputhje me qëllimin për të cilat janë dhënë këto kompetenca. 2. Veprimi administrativ që cenon apo mund të cenojë një të drejtë apo interes juridik të një personi, duhet të jetë i autorizuar nga një ligj....*

Përkitazi me pretendimin ankimor të ankuesve se anëtari i Komisionit Disiplinor nuk ka lajmëruar konfliktin e interesit në këtë procedurë, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave nga vlerësimi i shkresave të lëndës ka gjetur se ankuesi sipas Vendimit të datës 12.01.2026 ka qenë Kryetar i Komisionit Disiplinor për Drejtorinë e Burgut të Sigurisë së Lartë, dhe së i njëjti me datë 19.01.2016 kishte vendos në procedurë disiplinore të filluar ndaj duke propozuar shqiptimin e masës disiplinore "qortim me vërejtje me shkrim", ndërsa konfrom këtij vendimi ankuesi në cilësi të Drejtorit të Burgut të Sigurisë me Vendimin e datës 20.01.2016 ndaj ka shqiptuar masën disiplinore "qortim me vërejtje me shkrim", Andaj, Kolegji vlerësoj së nxjerrja e vendimit të goditur me ankesë, mbi bazën e ekzistimit të këtyre rrethanave të konfliktit të interesit është në kundërshtim të plotë me dispozitat e nenit 29 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 dhe 1.10 të Ligji Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative si dhe nenin 10 paragrafin 5 nën paragrafin 5.2 të Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publik, përcaktohet se: *"Në rast kur Kryesuesi apo anëtarët e komisionit disiplinor kanë konflikt interesi apo kur konflikti interesi paraqitet ndërkohë ata zëvendësohen nga Udhëheqësi më i Lartë Administrativ i Institucionit për raste si në vijim: Kur kryesuesi apo anëtari i komisionit ka qenë i dëmtuar nga shkelësi i dyshuar".*

Mbi këtë gjendje të fakteve, Kolegji konstaton së vendimi i kundërshtuar me ankesë është i përfshirë më të meta të atilla që pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së tij, kështu që organi i punësimit gjegjësisht Komisioni Disiplinor në riprocedurë duhet të eliminoj shkeljet e konstatuar sipas këtij vendimi, dhe të të nxjerr vendim në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe në mbështetje të fakteve të vërtetuara në mënyrë të plotë dhe drejtë.

Siç u tha me sipër, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.377/2022

**Avdyl BEKTESHI**

*Avdyl Bekteshi*  
Procesmbajtës

**Ardita Haxhnikaj-DEMI**

*Ardita Haxhnikaj-Demi*  
Kryetare e Kolegjit



**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesve
- Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës;
- Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

